



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 4.11.2020

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR VLERËSIMIN NË PARIM TË PROJEKTLIGJIT

“PËR BUXHETIN E VITIT 2021”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në 6 mbledhje, të zhvilluara në datat 26, 28 e 30 tetor dhe 2, 3 e 4 nëntor 2020, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.

Komisioni caktoi relatorë, për këtë projektligj, z. Anastas Angjeli dhe znj. Blerina Gjylameti. Në të gjitha mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm Ministrja e Financave dhe drejtues të stafit të kësaj ministrie.

Projektbuxheti, si çdo vit, u shqyrtua sipas një kalendari të posaçëm pune, të koordinuar me komisionet e tjera të Kuvendit. Komisioni shqyrtoi politikat dhe treguesit e përgjithshëm të projektbuxhetit, si dhe analizoi në detaj pjesët e veçanta të tij, si të ardhurat, shpenzimet, defiçitin buxhetor e borxhin publik.

Në një mbledhje të posaçme, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me drejtuesit e Bankës së Shqipërisë, për të marrë opinionin e këtij institucioni mbi projektbuxhetin.

Gjithashtu, Komisioni zhvilloi seanca dëgjimore me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe drejtues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për t’u njohur më në detaj dhe për të analizuar më në thellësi projektbuxhetin në këta sektorë prioritarë.

Shqyrtimi i projektligjit për buxhetin e vitit të ardhshëm është një akt i përvitshëm kushtetues i Kuvendit. Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” është hartuar në kontekstin e një rritjeje ekonomike pozitive e të qëndrueshme të vendit dhe thellimit të konsolidimit fiskal gjatë periudhës 2014-2019, si dhe specifikës që paraqet viti 2020, për shkak të goditjeve që pësoi ekonomia e vendit nga tërmeti i datës 26 nëntor të vitit të mëparshëm dhe pandemia shëndetësore COVID-19. Këto dy goditje ndikuan negativisht në ekonominë e vendit. Si rezultat i këtyre goditjeve, ekonomia e vendit kaloi nga rritja e qëndrueshme dhe pozitive e viteve të mëparshme, në rrencion gjatë vitit 2020. Kjo bëri që vendi ynë të heqë dorë, përkohësisht, nga politika e konsolidimit fiskal dhe të marrë masat e nevojshme ekonomike e sociale në mbështetje të shtresave më vulnerabël të popullsisë dhe bizneseve.

Gjatë vitit 2021 ekonomia e vendit parashikohet të rikuperohet dhe t’i rikthehet rritjes pozitive, duke iu rikthyer njëkohësisht edhe politikës së konsolidimit fiskal, e cila pritet të thellohet gjatë periudhës afatmesme.

Që prej vitit 2015, projektbuxheti vjetor paraqitet si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, duke përcaktuar dhe harmonizuar politikat, prioritetet dhe treguesit për vitin e ardhshëm me ato të periudhës afatmesme 2021-2023.

Politikat, treguesit dhe objektivat e projektbuxhetit mbështeten në:

- Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike;
- Kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm 2021-2023;
- Programin e Qeverisë;
- Politikat dhe prioritetet e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë për të përballuar vështirësitë aktuale që po kalon vendi;
- Ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore përkatëse etj.

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tri vitet në vijim. Ky dokument synon ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimin e klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimin sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Europian. Këto synime të kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm parashikohen të realizohen nëpërmjet zbatimit të disa objektiveve, siç janë:

- Synimi i një trajektoreje rënëse të borxhit publik, duke targetuar si objektivi operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit prej vitit buxhetor 2023 dhe në vijim. Që prej Korrikut 2020, ky objektivi është sanksionuar edhe në ligjin organik të buxhetit, nëpërmjet përfshirjes së një rregulli të ri fiskal.
- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 4.5 përqind të PBB mesatarisht çdo vit.

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektiv themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 përqind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare.
- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këto objektiva themelore përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal, brenda të cilave përcaktohen projeksionet e detajuara.

Politikat dhe treguesit e projektbuxhetit mbështeten në trendin e zhvillimit të ekonomisë së vendit në vite, zhvillimet dhe politikat ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme për vitin 2021, si dhe pritshmëritë për zhvillimin afatmesëm.

Vlerësimi nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Projektbuxheti mban në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si Komisioni Europian, FMN e Banka Botërore, si dhe të agjencive ndërkombëtare që mbikëqyrin ekonominë e vendit tonë. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Këto institucione kanë theksuar se kufizimi i lëvizjeve dhe masat e distancimit social ndikuan në ecurinë e dy sektorëve kyç të ekonomisë, siç janë turizmi dhe industria prodhuese. Këta sektorë po vuajnë më shumë pasojat e recesionit të Bashkimit Europian, që është njëherazi edhe partneri kryesor tregtar, i investimeve të huaja dhe i dërgesave të emigrantëve. Mbyllja e bizneseve dhe ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit dëmtojnë prodhimin. Konsumi dhe investimet u reduktuan. Si rezultat, PBB-ja e Shqipërisë pritet të tkurret.

Institucionet financiare ndërkombëtare kanë vlerësuar pozitivisht politikat shtetërore në vendin tonë për zbutjen e efekteve të tërmetit të muajit nëntor 2019 dhe pandemisë shëndetësore COVID-19. Ato kanë theksuar se menaxhimi i politikave ka qenë i përshtatshëm, janë krijuar kushtet financiare lehtësuese për qytetarët dhe bizneset dhe stabiliteti makroekonomik i vendit është ruajtur. Rritja e deficitit fiskal, gjatë vitit 2020, është e përligjur, për të zbutur ndikimin e krizës.

Gjithashtu, këto institucione vlerësuan pozitivisht politikat për rritjen e pagave, rritjen e shpenzimeve sociale, shtyrjen e përkohshme të afateve të shlyerjes së huasë dhe ofrimin e garancisë sovrane të kredisë, për të lehtësuar biznesin në dhënien e pagave për punëmarrësit dhe për të ndikuar në rritjen e kapitalit qarkullues.

Këto institucione kanë vlerësuar se pozicioni fiskal i Shqipërisë pritet të përkeqësohet në vitin 2020, pasi deficieti pritet të thellohet. Ekonomia shqiptare mund të rimëkëmbet vitin e ardhshëm, në rast se situata e pandemisë mbahet nën kontroll. Nxitje për rritjen ekonomike do të sjellin edhe procesi i rindërtimit, turizmi dhe ndërtimi.

Këto institucione kanë dhënë edhe disa rekomandime për politikën buxhetore që duhet të ndiqen gjatë vitit 2021 e më tej, kur pasojat e krizës të zbuten, për rimëkëmbjen ekonomike, rifillimin e konsolidimit fiskal dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit.

Opinionin e Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin.

Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë paraqiti opinionin e këtij institucioni për projektbuxhetin e vitit 2021. Ajo theksoi se projektbuxheti parashikon ruajtjen e një kahu stimulues të politikës fiskale gjatë vitit të ardhshëm, ruan një nivel të lartë investimesh publike dhe është në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit.

Më tej, Zëvendësguvernatorja u ndal në goditjet nga dy fatkeqësitë natyrore që pësoi vendi, tërmetin e datës 26 nëntor 2019 dhe pandeminë shëndetësore Covid-19, të cilat patën një ndikim të fortë negativ në ekonomi gjatë vitit 2020, duke e çuar atë në recension. Ajo theksoi se politikën ekonomike stimuluese, të ndjekura deri tani, kanë pasur një rol vendimtar në përballimin e goditjes dhe krijimin e premisave për rritje.

Stimuli fiskal ka amortizuar pjesërisht ndikimin negativ të pandemisë në të ardhurat e familjeve shqiptare, ka ndihmuar në lehtësimin e ndikimit negativ mbi flukset financiare të bizneseve, si dhe ka gjeneruar fonde shtesë për përballimin e emergjencës shëndetësore.

Politikën fiskale u harmonizuan me politikën monetare, nëpërmjet një paktete të plotë masash, të ndërmarrura nga Banka e Shqipërisë, siç janë ulja e normës bazë të interesit në minimumin historik prej 0.5 për qind, ofrimi i pakufizuar i likuiditetit për sektorin bankar, shtyrja apo ristrukturimi i kredive, eliminimi i kostove të përdorimit të infrastrukturës së sistemit të pagesave në monedhë kombëtare, anulimi i pagesave të dividendit gjatë vitit 2020 dhe vazhdimi i programeve të mbikëqyrjes *on-* dhe *off-site*. Kombinimi i politikave ekonomike duhet të mbetet stimulues edhe për të ardhmen e afërt.

Banka e Shqipërisë gjykon se projektbuxheti bazohet në premisën e një rikuperimi gradual të ekonomisë gjatë vitit të ardhshëm. Ruajtja e kahut lehtësues të politikës fiskale, masat tatimore dhe raporti i shpenzimeve publike korrente ndaj atyre kapitale, janë në përputhje me nevojat afatshkurtra dhe afatgjata të zhvillimit të vendit. Investimet publike janë elementi më efektiv i stimujve fiskalë, me ndikim pozitiv në rritjen e potencialit prodhues të vendit. Banka e Shqipërisë konstaton se efekti i pritjes së masave fiskale mbi inflacionin do të jetë relativisht i ulët dhe kalimtar.

Një ndër objektivat kryesorë të projektbuxhetit është rivendosja e borxhit në trajektore rënëse, pas goditjes së marrë në vitin 2020. Reduktimi i borxhit publik duhet të jetë një objektivi primar i politikës fiskale edhe në të ardhmen.

Në fushën e huamarrjes, Banka e Shqipërisë sugjeron monitorimin e vazhdueshëm të tregjeve financiare, vazhdimin e dialogut dhe bashkëpunimit midis institucioneve, përmirësimin strukturor të sistemit financiar si dhe rritjen e efikasitetit të tregut sekondar të letrave me vlerë.

Në përfundim, Zëvendësguvernatorja paraqiti disa sugjerime për përmirësimin e harmonizimit të politikës fiskale me atë monetare dhe rritjen e efektivitetit të financave publike.

II. Baza ligjore.

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- Nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 29 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Shqyrtimi i këtij projektligji u zhvillua sipas procedurave të përcaktuara në nenet 78-81 të Rregullores së Kuvendit.

III. Përmbajtja e projektligjit.

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” pasqyron një set tabelash me të dhëna statistikore mbi të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e Buxhetit të Shtetit, fondet speciale qendrore dhe transfertat nga Buxheti i Shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për vitin buxhetor. Gjithashtu, ai përcakton rregullat për përdorimin e fondeve buxhetore. Projektligji shoqërohet me një raport, ku analizohet në mënyrë të hollësishme, realizimi i treguesve makroekonomikë e fiskalë për vitin 2020 dhe parashikimet për vitin 2021 e periudhën afatmesme 2021-2023. Raporti përmban edhe një analizë të hollësishme për buxhetin e njësisë të qeverisjes qendrore e vendore, si dhe të dhe fondeve speciale.

IV. Diskutimi në Komision.

Në mbledhjet e Komisionit paraqitën prezantime dhe iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë, Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, si dhe drejtues të tjerë të ministrive të ftuara për t’u dëgjuar.

Relatori i projektligjit paraqiti prezantime për projektbuxhetin në tërësi dhe për pjesët e veçanta të tij. Në këto prezantime ai analizoi treguesit makroekonomikë e fiskalë për vitet 2020, 2021 dhe

periudhën afatmesme 2021-2023. Në përfundim, relatori paraqiti disa sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të politikave buxhetore gjatë vitit 2021 e më tej.

Në mbledhjet e Komisionit deputetët paraqitën shumë pyetje e diskutime. Shumica e anëtarëve të Komisionit mbështeti vlerësimin e bërë nga relatori për projektbuxhetin vjetor e afatmesëm, si dhe politikat respektive, si më poshtë:

IV.1. Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2020.

Ekonomia e vendit, gjatë viteve 2014-2019, u zhvillua me ritme pozitive. Trendi i PBB reale erdhi në rritje, nga 1.8 për qind në vitin 2014, në 4.1 për qind në vitin 2018. Në vitin 2019, rritja reale e PBB përsëri ishte me ritme pozitive, por me trend më të ulët, 2.2 për qind, si pasojë e rënies së prodhimit të energjisë elektrike; rritjes më të ngadaltë të sektorit të ndërtimit, si rezultat e hyrjes në fazën përfundimtare të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP); si dhe i tërmetit të nëntorit të vitit 2019. Ky trend pozitiv i zhvillimit u pasqyrua në një sërë parametrash makroekonomikë, veçanërisht në thellimin e konsolidimit fiskal. Borxhi publik u reduktua nga 72 për qind e PBB në vitin 2014, në 66.3 për qind të PBB në vitin 2019.

Në vitin 2020 ekonomia e vendit po vuan goditjet e dy fatkeqësive natyrore, tërmetit të datës 26 nëntor 2019 dhe pandemisë shëndetësore COVID-19. Këto dy goditje patën ndikim të fortë negativ në rritjen ekonomike të vitit 2020, duke e cuar ekonominë e vendit në recension.

Tërmeti solli humbje të mëdha në jetë njerëzore dhe dëmtoi një numër të madh banesash e asetesh infrastrukturore. Dëmi ekonomik nga tërmeti ishte 1.1 miliardë lekë, ndërsa PBB u reduktua me 7 për qind. Këshilli i Ministrave shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore dhe mori masa të menjëhershme për trajtimin financiar të familjeve të viktimave, strehimin e familjeve që humbën banesat dhe hartimin e kuadrit ligjor për Programin e Rindërtimit. Ky Program parashikon strehimin në banesa të reja falas të qytetarëve të prekur nga tërmeti, rindërtimin e infrastrukturës publike e kritike, rindërtimin e objekteve arsimore dhe publike të dëmtuara, mbështetjen me pagesa direkte të familjeve që u janë dëmtuar banesat, si dhe rimëkëmbjen ekonomike e sociale në territorin e 11 bashkive të dëmtuara.

Për vitin 2020, programi i rindërtimit u financua me një buxhet prej 34 miliardë lekësh, nga të cilat 31 miliardë lekë nga buxheti i shtetit dhe 3 miliardë lekë grante. Programi i rindërtimit përbëhet nga:

- Granti për rindërtimin ose rikonstruksionin e banesave të dëmtuara prej rreth 10 miliardë lekësh;
- Pagesa e qirasë për familjet e mbetura pa strehë, për të cilën janë dibursuar 2 miliardë lekë dhe kanë përfituar mbi 13091 persona;
- Programi i ndërtimit të banesave të reja.


Vendi ynë u përfshi në efektet e pandemisë shëndetësore botërore COVID-19 në muajin mars 2020 dhe vijon të jetë nën ndikimin e saj negativ. Për të kufizuar përhapjen e pandemisë, Këshilli i Ministrave mori masa për kufizimin e lëvizjes së individëve dhe mjeteve të transportit. Masa të tjera u morën edhe në drejtim të furnizimit të pandërprerë me barna, pajisje shëndetësore dhe shërbime spitalore; mbajtjes së rezervave nga subjektet që tregtojnë produkte ushqimore; si dhe ushtrimit të veprimtarisë në sektorin e turizmit.

Krahas këtyre masave, Kuvendi miratoi, gradualisht, një sërë lehtësish fiskale për qytetarët dhe bizneset më të prekura nga pandemia. Masat e marra për kontrollin e përhapjes së pandemisë ndikuan në rënien e konsumit, investimeve dhe eksporteve të mallrave dhe shërbimeve.

Për të zbutur efektet e pandemisë shëndetësore, u alokuan 2.4 miliardë lekë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Përveç kësaj, sistemi shëndetësor u financua me rreth 507 milionë lekë ndihma nga organizatat ndërkombëtare, të destinuara për pajisje mjekësore, masa mbrojtëse dhe medikamente. Sistemi shëndetësor arriti të përballojë me sukses sëmundjen, duke krijuar mjediset spitalore të nevojshme për situatën COVID, duke i pajisur ato me aparatura të reja, duke siguruar terapinë dhe medikamentet e nevojshme mjekësore, duke rritur kapacitetet laboratorike të testimit për këtë sëmundje, duke fuqizuar shërbimin e urgjencës mjekësore etj. Për personelin shëndetësor, në vijën e parë të luftës, u përcaktua një shpërblim financiar, mbi pagën mujore, prej 1000 eurosh, ndërsa për stafin mbështetës prej 500 eurosh.

Në rënien e investimeve ka ndikuar edhe ndërtimi i gazsjellësit TAP, i cili është drejt përfundimit. Por, ky projekt pritet të japë ndikim mjaft pozitiv në të ardhmen, duke siguruar një burim alternativ të furnizimit me energji elektrike. Si rrjedhojë, pritshmëritë janë që PBB, për vitin 2020, të kalojë nga rritja pozitive e viteve të mëparshme, në recension prej (-6.1) për qind.

Ndryshimi i PBB reale në vite paraqitet më poshtë:



Nga pikëpamja e ofertës agregate, degët që kanë kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike, gjatë vitit 2020, janë bujqësia dhe aktivitetet e pasurisë së paluajtshme. Degët e tjera të ekonomisë, si tregtia, ndërtimi, industria etj, pësuan rënie.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë dhe bilanci i pagesave mbeten të qëndrueshëm. Investimet e huaja direkte pësuan rënie nga 7.6 për qind e PBB, në 6.7 për qind të PBB.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2020, parashikohen të arrijnë nivelin 431.7 miliardë lekë. Këto të ardhura përbëjnë 27.5 për qind të PBB, nga 27.4 për qind e PBB që ishin një vit më parë. Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura rezultojnë me ulje për rreth 28.6 miliardë lekë ose 6.2 pikë përqindje. Në përqindje ndaj PBB, këto të ardhura priten të arrijnë nivelin e vitit 2018.

Ky nivel i të ardhurave të përgjithshme të buxhetit reflekton reduktimin e PBB gjatë vitit 2020 dhe politikat lehtësuese fiskale të zbatuara gjatë këtij viti.

Politikat lehtësuese fiskale.

Gjatë vitit 2020 u miratuan një sërë politikash lehtësuese fiskale për qytetarët dhe bizneset, ndër të cilat më kryesoret janë:

A. Masa fiskale urgjente, të ndërmarra nëpërmjet akteve normative të Këshillit të Ministrave gjatë periudhës mars-qershor 2020, për t’iu përgjigjur efekteve të mbylljes ekonomike, të shkaktuar nga pandemia Covid-19:

1. Mospagimi, gjatë vitit 2020, i detyrimeve tatimore mbi të ardhurat për bizneset e vogla;
2. Mospagimi, gjatë vitit 2020, i detyrimeve tatimore mbi të ardhurat për bizneset e mëdha, që operojnë në veprimtaritë e goditura nga pandemia, si turizmi, industria fason, call center etj;
3. Shtyrja e afatit të dorëzimit të deklaratave dhe pagesës së detyrimit të fitimit të vitit 2019.

B. Masa të tjera fiskale, në mbështetje të sportit (në vijim të masave të miratuara në dhjetor 2019):

1. Përjashtimi, nga tatimi mbi pagën e sportistëve, për vitet 2021 dhe 2022;
2. Ulja e TVSH-së, nga 20 për qind, në TVSH të reduktuar 6 për qind, për ndërtimin e infrastrukturës sportive.

C. Ulje taksash për vitet 2021 e në vijim:

1. Tatimi thjeshtuar mbi fitimin për subjektet me të ardhura 5-8 milionë lekë, nga 5 për qind, u bë zero. Nga kjo masë përfitojnë 18 mijë subjekte. (Taksa për 60 mijë subjekte, me të ardhura 0-5 milionë lekë, ka qenë zero që në vitin 2015).
2. Tatimi mbi fitimin, për subjektet me të ardhura 8-14 milionë lekë nga 5 për qind, u bë zero. Nga kjo masë përfitojnë 12 mijë subjekte.
3. Heqja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për kompanitë që janë dëmtuar nga tërmeti i vitit 2019 (për qytetarët, kjo taksë ishte hequr në dhjetor 2019).
4. Përjashtimi nga TVSH-së i importit të jahteve, me qëllim nxitjen e turizmit detar.
5. Rritja e pragut të TVSH-së nga 2 milionë lekë, në 10 milionë lekë. Nga kjo masë përfitojnë rreth 32 mijë subjekte, të cilat dalin nga skema e TVSH-së.

Ç. Masa të tjera administrative.

1. *Fiskalizimi.*
Nga 1 Janari 2021 fillon zbatimi i projektit të fiskalizimit për transaksionet biznes-Qeveri.
2. *Shkëmbimi automatik i informacionit.*
Realizimi i këtij procesi do të ndihmojë në:
 - a. Rritjen e bashkëpunimit të vendit tonë me vendet e tjera në fushën e transparencës fiskale;
 - b. Sigurimin e informacionit mbi të ardhurat e rezidentëve shqiptarë jashtë vendit.
3. *Regjistri i përfituesve.*
Realizimi i këtij procesi do të ndihmojë në:
 - a. Rritjen e bashkëpunimit në fushën ndërkombëtare;
 - b. Parandalimin e investimeve me burime financiare të dyshimta.
4. *Regjistri i llogarive bankare.*
Realizimi i këtij procesi do të ndihmojë në:
 - a. Rritjen e transparencës;
 - b. Krijimin e bazës së të dhënave për veprimtarinë ligjore të agjencive ligjzbatuese.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2020, parashikohen të arrijnë nivelin 538.5 miliardë lekë. Në krahasim me një vit më parë, shpenzimet e përgjithshme rezultojnë me rritje për rreth 47 miliardë lekë ose 9.5 pikë përqindje. Këto shpenzime përbëjnë 34.2 për qind të PBB, nga 29.3 për qind të PBB që ishin një vit më parë. Në krahasim me planin e rishikuar të buxhetit 2020, këto shpenzime rezultojnë me ulje për rreth 41 miliardë lekë ose 7.1 pikë përqindje.

Ndikimin më të madh në rritjen e shpenzimeve e ka dhënë fondi i rindërtimit pas tërmetit prej 34 miliardë lekësh, nga të cilat rreth 31 miliardë lekë është fondi i buxhetit të shtetit dhe 3 miliardë lekë janë grant.

Një ndikim të madh në rritjen e shpenzimeve të vitit 2020, në krahasim me një vit më parë, kanë dhënë edhe shpenzimet mbështetëse për masat kundër pandemisë COVID-19.

Realizimi i shpenzimeve sipas dy grupeve kryesore, paraqitet si më poshtë:

- *Shpenzimet korrente* përbëjnë rreth 79 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Në krahasim me planin e rishikuar me akt normativ, këto shpenzime u realizuan në masën 96.2 për qind, me një mosrealizim prej rreth 17 miliardë lekësh.
- *Shpenzimet kapitale* përbëjnë rreth 19 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Në krahasim me planin e rishikuar me akt normativ, këto shpenzime u realizuan në masën 116 për qind, me një tejkalim prej 14 miliardë lekësh.

Deficiti buxhetor dhe borxhi publik.

Gjatë periudhës 2014-2019 financat publike u karakterizuan nga qëndrueshmëria dhe thellimi i konsolidimit fiskal. Deficiti buxhetor dhe borxhi publik, në përqindje ndaj PBB, erdhën në rënie. Borxhi publik u reduktua gradualisht çdo vit, duke arritur nivelin 66.3 për qind të PBB në vitin 2019, nga 72.7 për qind e PBB në vitin 2015. Bilanci primar, i cili në vitin 2013 ishte negativ, u kthye në pozitiv në vitet 2016-2019. Gjithashtu, u përmirësua struktura e borxhit, duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë e tij.

Gjatë vitit 2020, për të zbutur efektet e dy goditjeve natyrore që pësoi vendi, u anashkalua politika e konsolidimit fiskal. Si rrjedhojë, deficiti buxhetor i këtij viti parashikohet të arrijë nivelin 6.8 për qind të PBB, ndërsa borxhi publik parashikohet 80.9 për qind e PBB. Vitin e ardhshëm vendi do t'i rikthehet konsolidimit fiskal, i cili pritet të thellohet gjatë periudhës afatmesme.

IV.2. Karakteristikat kryesore të projektbuxhetit 2021 dhe të projektbuxhetit afatmesëm 2021-2023.

Projektbuxheti i vitit 2021 mund të konsiderohet si projektbuxheti i rimëkëmbjes ekonomike të vendit, pasi synon të përballojë efektet negative të tërmetit dhe të pandemisë shëndetësore COVID-19.

Treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë të projektbuxhetit 2021 janë si më poshtë:

- PBB nominale 1682 miliardë lekë ose 16 miliardë USD ose 13.6 miliardë euro;
- Rritja reale e PBB 5.5 %;
- Inflacioni 2.4 %;
- Të ardhurat 28.5 % e PBB;
- Shpenzimet 34.9 % e PBB;

- Defiçiti buxhetor 6.5 % e PBB;
- Borxhi publik 78.6 % e PBB;
- Investimet publike 7.2 % e PBB;
- Norma e papunësisë 12.2 % e PBB.

Karakteristikat kryesore të projektbuxhetit 2021 janë si më poshtë:

Së pari, rikuperimi i rritjes ekonomike dhe kthimi i saj në trend pozitiv.

Ekonomia e vendit, pas recensionit të fortë që pësoi gjatë vitit 2020, në vitin 2021 parashikohet të kthehet në trend pozitiv dhe të vijojë të jetë pozitive edhe gjatë periudhës afatmesme. Rritja reale e PBB parashikohet të jetë 5.5 për qind në vitin 2021, 4.8 për qind në vitin 2022 dhe 4.5 për qind në vitin 2023.

Ky nivel i rritjes ekonomike parashikohet të arrihet nëpërmjet rritjes së kërkesës së brendshme, si përmes rritjes së konsumit privat, ashtu edhe rritjes së investimeve. Kërkesa e huaj parashikohet të ketë një efekt të lehtë pozitiv.

Konsumi privat parashikohet të nxitet nga përmirësimi i besimit të konsumatorit dhe përmirësimet në tregun e punës. Përmirësimet në tregun e punës do të ndikojnë në rritjen graduale të pagave, duke stimuluar të ardhurat reale të disponueshme të individëve. Kjo do të çojë në nxitjen e konsumit dhe të kreditimit të tij. Kredia për konsum parashikohet të nxitet nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme.

Rritja e investimeve parashikohet të nxitet nga përmirësimi i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, përsheptimi i aktivitetit ekonomik dhe përmirësimi i perceptimit të biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme dhe afatgjatë. Përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies do të ndikojnë në nxitjen e investimeve private në periudhën afatmesme.

Eksportet e mallrave e shërbimeve parashikohen të rriten. Ndikim pozitiv pritet të ketë eksporti i shërbimeve turistike, i cili pritet të rikthejë performancën pozitive dhe të japë ndikimin kryesor në kompensimin e deficitit të importeve.

Së dyti, rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit parashikohet të jetë faktori kryesor për realizimin e rimëkëmbjes ekonomike dhe thellimin e konsolidimit fiskal të vendit si për vitin 2021, ashtu edhe për periudhën afatmesme.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2021, parashikohet të rriten me 47.2 miliardë lekë ose 10.9 pikë përqindje. Këto të ardhura parashikohen të arrijnë 28.5 për qind të PBB, nga 27.5 për qind të PBB që pritet të jenë në vitin 2020.

Rritja e të ardhurave parashikohet të vijë nga rritja e PBB, rritja e volumit të importeve, konjuktura e çmimeve ndërkombëtare, përmirësimi i administrimit fiskal dhe thellimi i luftës kundër informalitetit e evazionit fiskal. Rritja ekonomike pritet të sjellë rritje të pagës mesatare dhe rritje të numrit të të punësuarve në sektorin privat. Këta faktorë, si dhe nxitja e punësimit për të mbështetur sistemin shëndetësor në luftën kundër pandemisë, pritet të sjellin rritje të të ardhurave të buxhetit. Ndikim pozitiv priten të ketë edhe rritja e pagës minimale nga 26 mijë lekë, në 30 mijë lekë.

Rritja e të ardhurave buxhetore sipas grupeve kryesore parashikohet si më poshtë:

- *Të ardhurat nga tatimet dhe doganat* përbëjnë rreth 64.9 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 34 miliardë lekë ose 12.2 pikë përqindje.
- *Të ardhurat nga fondet speciale* përbëjnë rreth 21 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 6.5 miliardë lekë ose 6.9 pikë përqindje.
- *Të ardhurat nga pushteti vendor* përbëjnë rreth 5.3 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 2.4 miliardë lekë ose 10.3 pikë përqindje.
- *Të ardhurat jotatimore* përbëjnë rreth 4.5 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 2 miliardë lekë ose 10.6 pikë përqindje.
- *Të ardhurat nga ndihmat* përbëjnë rreth 4.2 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 2.4 miliardë lekë ose 13.1 pikë përqindje.

Politikat fiskale, për vitin 2021, përcaktojnë lehtësi për bizneset dhe individët, me qëllim zbutjen e pasojave të pandemisë shëndetësore. Si rrjedhojë, efektet e këtyre politikave në të ardhurat e buxhetit janë negative. Këto politika janë si më poshtë:

- Heqja e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për bizneset me xhiro 5-8 milionë lekë. Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt në buxhetin e shtetit prej (-0.35) miliardë lekësh.
- Heqja e tatimit mbi fitimin për biznesin me xhiro 8-14 milionë lekë; Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt në buxhetin e shtetit prej (- 0.3 miliardë lekësh).
- Rritja e pragut të TVSH-së nga 2 milionë lekë, në 10 milionë lekë (bizneset me të ardhura deri në 10 milionë lekë, nuk do të paguajnë TVSH). Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt në buxhetin e shtetit prej (- 3-4) miliardë lekësh.

- Rritja e pagës minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve nga 26 mijë lekë, në 30 mijë lekë. Kjo masë pritet të sjellë efekt në të ardhurat e vitit 2021 për rreth 3 miliardë lekë.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, edhe në periudhën afatmesme, parashikohen të rriten, duke arritur 28.7 për qind të PBB në vitin 2022 dhe 28.9 për qind të PBB në vitin 2023.

Së treti, rritja e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit dhe përmirësimi i cilësisë së tyre.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2021, parashikohet të rriten me 49.2 miliardë lekë ose 9.1 pikë përqindje. Këto shpenzime parashikohen të arrijnë 34.9 për qind të PBB, nga 34.2 për qind e PBB që priten të jenë në vitin 2020.

Gjatë vitin 2021 parashikohet të përmirësohet thellësisht cilësia e shpenzimeve, duke i dhënë prioritet shpenzimeve kapitale, në krahasim me ato korrente. Gjithashtu, tregues i një cilësie më të mirë të shpenzimeve buxhetore është edhe rritja e nivelit të mbështetjes për disa sektorë prioritarë, si arsim, shëndetësi, infrastrukturë, bujqësi e rindërtim. Zhvillimi i këtyre sektorëve pritet të garantojë stimuj pozitivë për rritjen ekonomike të vendit, duke gjeneruar njëkohësisht punësim të qëndrueshëm.

Rritja e shpenzimeve sipas grupeve kryesore parashikohet si më poshtë:

- *Shpenzimet korrente* përbëjnë rreth 78.8 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime parashikohet të rriten me rreth 38.3 miliardë lekë ose 9 pikë përqindje.
- *Shpenzimet kapitale* përbëjnë rreth 20.5 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime parashikohet të rriten me rreth 18.9 miliardë lekë ose 18.5 pikë përqindje.


Së katërti, rikthimi i ekonomisë drejt konsolidimit fiskal.

Gjatë vitit 2021, si rrjedhojë e përmirësimit të ritmeve të rritjes ekonomike, si dhe rritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, ekonomia parashikohet t'i rikthehet konsolidimit fiskal. Kjo vërehet në parashikimin e treguesve të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik, si më poshtë:

Defiçiti buxhetor parashikohet të jetë 6.5 për qind e PBB, nga 6.8 për qind e PBB që pritet të jetë në vitin 2020. Në vitet e ardhshme defiçiti buxhetor parashikohet me rënie të ndjeshme, duke arritur nivelin 2.3 për qind të PBB në vitin 2023.

- *Bilanci primar fiskal* parashikohet me një reduktim të defiçitetit, duke arritur nivelin (- 3.9) për qind të PBB, nga (- 4.6) për qind e PBB që pritet të jetë në vitin 2020, duke kaluar në nivel pozitiv në vitin 2023. Ky trend është në përputhje me rregullin e ri fiskal, të vendosur në ligjin organik të buxhetit në korrik të vitit 2020, sipas të cilit nga viti 2023 e në vijim bilanci primar duhet të jetë i balancuar ose pozitiv.
- *Bilanci korrent fiskal* parashikohet të rikthehet në nivel pozitiv, duke arritur nivelin 0.7 për qind të PBB, nga (- 0.3) për qind e PBB që pritet në vitin 2020. Kjo tregon që, për vitin 2021, të ardhurat e buxhetit do të financojnë shpenzimet korrente dhe një pjesë të shpenzimeve kapitale, duke vënë në zbatim rregullin e artë të buxhetit.

Borxhi publik parashikohet t'i rikthehet rënies, në përputhje me rregullin fiskal, duke arritur nivelin 78.6 për qind të PBB, nga 80.9 për qind e PBB që pritet të jetë në vitin 2020. Kjo rënie do të vijojë edhe në periudhën afatmesme, duke arritur nivelin 76.3 për qind të PBB në vitin 2023. Borxhi publik në vite paraqitet si më poshtë:



Së pesti, rritja e thellë e investimeve publike.

Rritja e investimeve publike është prioriteti kryesor i projektbuxhetit, për të krijuar kushtet për rritjen ekonomike, zgjerimin e veprimtarisë së biznesit, rritjen e punësimit etj. Investimet publike për vitin 2021 parashikohen në nivelin 120.6 miliardë lekë, me një rritje në krahasim me vitin 2020 prej rreth 19 miliardë lekësh ose 18.5 pikë përqindje. Ato përbëjnë 7.2 për qind të PBB dhe janë në nivelin më të lartë të 10 viteve të fundit.

Prioritet për investimet publike, ashtu si vitet e mëparshme, përbëjnë projektet në vazhdim. Planifikimi i investimeve publike mban në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktore për projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.

Së gjashti, mbështetja e rindërtimit pas tërmetit.

Për vitin 2021, një pjesë të rëndësishme të investimeve publike e zë **fondi i rindërtimit** pas tërmetit prej rreth 28 miliardë lekësh. Veç kësaj shume, në projektbuxhet është parashikuar edhe një fond prej 1.5 miliardë lekësh për përballimin e bonusit të qirasë për familjet e mbetura pa strehë. Nëpërmjet fondit të rindërtimit do të ndërtohen 3470 banesa individuale, 4646 banesa kolektive, 145 objekte arsimore dhe e gjithë infrastruktura e nevojshme për vënien në funksion të plotë të tyre.

Së shtati, përballimi i situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Menaxhimi i situatës së pandemisë shëndetësore COVID-19, për vitin 2021, është një prioritet i rëndësishëm i projektbuxhetit. Projektbuxheti parashikon fondet e nevojshme buxhetore, për të siguruar mbulim shëndetësor për të gjithë qytetarët, mbrojtje të personelit mjekësor, forcim të hetimit epidemiologjik dhe të diagnostikimit në kohë të pacientëve. Projektbuxheti për vitin 2021 parashikon një fond prej rreth 6 miliardë lekësh për përballimin e pandemisë. Në këtë fond përfshihen edhe shpenzimet për vaksinën anti-COVID. Këtu **nuk** përfshihet fondi për rritjen e pagave në sektorin e shëndetësisë.

Prioritete për vitin 2021 janë ruajtja e vazhdimësisë së shërbimeve spitalore, duke u përshtatur edhe me kërkesat e reja që mund të paraqiten në të ardhmen në kuadër të pandemisë. Gjithashtu, prioritete janë edhe forcimi i shërbimit të urgjencës mjekësore, hartimi i protokolleve për trajtim të pacientëve në banesë, shtimi i kapaciteteve, fuqizimi i rolit të mjekut të përgjithshëm etj.

Së teti, rritja e pagave në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë.

Projektbuxheti parashikon rritjen e pagave në dy sektorët prioritarë, arsim e shëndetësi, me një efekt prej 8 miliardë lekësh. Pagat për funksion, për këta dy sektorë, rriten si më poshtë:

- ✓ Për punonjësit e shëndetësisë pagat rriten me 40 për qind, me një efekt prej 4.5 miliardë lekësh;
- ✓ Për punonjësit e arsimit pagat rriten me 15 për qind, me një efekt prej 3.5 miliardë lekësh.

Nga kjo politikë e re e rritjes së pagave përfitojnë rreth:

- 4 700 mjekë në kujdesin parësor e dytësor;
- 13 800 infermierë dhe laborantë;
- 35 900 mësues të arsimit parauniversitar.

Së nënti, konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor.

Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore vijon të mbetet prioritet i projektbuxhetit. Reforma administrativo-territoriale parashikohet të vijojë, duke synuar përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Buxheti vendor i vitit 2021, parashikohet të jetë rreth 5.3 përqind më i lartë se ai i vitit 2020 ose në nivelin 3.3 për qind të PBB-së. Krahasuar me vitin 2015, buxheti vendor për vitin 2021 paraqitet me një rritje të ndjeshme me rreth 65.3 përqind. Në buxhetin vendor parashikohet një fond prej 500 milionë lekësh për emergjencat civile.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, për vitin 2021, parashikohet të kenë një rritje prej 2.3 miliard lekësh ose 10 pikë përqindje në krahasim me vitin 2020 . Kjo rritje e nivelit të të ardhurave parashikohet të vazhdojë, si rrjedhojë e ndarjes më të drejtë dhe transparente të financave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta si dhe rritjes së burimeve të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, ndryshimet që po zbatohen në taksën e pronës dhe kadastrën fiskale parashikohen të ndikojnë në rritjen e të ardhurave të buxhetit vendor.

Rekomandime.

Pas analizës së projektbuxhetit për vitin 2021 dhe periudhën afatmesme 2021-2023, relatori parashtroi disa mendime e sugjerime, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike në të ardhmen, si më poshtë:

1. Rritja e të ardhurave të buxhetit me ritëm shumë të lartë kërkon nga administratat tatimore e doganore që të rrisin më shumë përpjekjet për administrimin me cilësi të tyre. Veçanërisht, duhet të rriten përpjekjet për të ndërtuar një sistem më të drejtë, më të thjeshtë, më efikas dhe më transparent tatimor, i cili nxit rritjen e të ardhurave. Gjithashtu, më shumë përpjekje duhet të bëhen për të reduktuar evazionin fiskal dhe informalitetin që ekziston në këtë sektor. Përgatitja e një strategjie afatmesme për të ardhurat duhet të jetë një tjetër objektiv, pasi do të ndihmojë në përmirësimin e sistemit tatimor dhe rritjen e të ardhurave të buxhetit.

2. Kryerja e shpenzimeve në afat e me cilësi duhet të jetë një ndër objektivat kryesore të çdo institucioni buxhetor. Për kryerjen me cilësi të shpenzimeve, prioritet duhet t'u jepet sektorëve strategjikë, që sjellin zhvillim më të madh në ekonomi. Gjithashtu, në kryerjen e shpenzimeve institucionet buxhetore duhet të orientohen drejt projekteve më të studiuar, që japin efekt më të madh në gjallërimin e ekonomisë dhe punësim. Detyrimet dhe kriteret ligjore, veçanërisht procedurat e prokurimit publik, duhet të respektohen me rigozitet nga çdo institucion buxhetor.

3. Një ndër prioritetet kryesore të vitit 2021 është vijimi i mbështetjes së sektorit të shëndetësisë, për të menaxhuar me kujdes pasojat e pandemisë shëndetësore që po kalon vendi, ashtu si e gjithë bota. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet furnizimit me medikamente e pajisje mjekësore, mbështetjes së vaksinimit etj. Përdorimi i fondeve buxhetore, për këtë qëllim, duhet të jetë efikas

dhe transparent. Rëndësi të veçantë ka menaxhimi i risqeve në rast të mundshëm të zgjatjes së pandemisë, për shkak të ndikimit negativ të saj në sektorët e turizmit e të industrisë përpunuese. Në këtë rast, duhet të vijnë masat lehtësuese ndaj qytetarëve e bizneseve. Nga ana tjetër, kërkohen më shumë përpjekje për një zhvillim të ekonomisë në drejtime novatore, siç janë ekonomia dixhitale, ekonomia e gjelbër etj, për të siguruar hapësirat e nevojshme fiskale për rritjen ekonomike dhe uljen e borxhit publik.

4. Procesi i rindërtimit pas tërmetit mbetet një prioritet tjetër mjaft i rëndësishëm për vitin 2020. Vijimi i këtij procesi duhet të bazohet në një kuadër institucional të konsoliduar, transparent dhe llogaridhënës. Strukturat e ngarkuara për këtë qëllim duhet të realizojnë detyrimet me cilësi dhe brenda afateve të parashikuara, për t'u ardhur në ndihmë sa më parë banorëve të zonave të dëmtuara nga tërmeti.

5. Përmirësimi i klimës së biznesit është një prioritet tjetër i rëndësishëm, për faktin se ai është kontribuesi më i madh në buxhet, por edhe përfituesi më i madh nga politikat fiskale dhe buxhetore. Politikat për ristrukturimin e ekonomisë, si dhe rritjen e lirive ekonomike dhe mbështetjen financiare të biznesit duhet të vijnë, megjithë vështirësitë që paraqet situata e pandemisë.

6. Investimet në zërin e emergjencave civile, në institucionet studimore dhe projektuese, duhet të rriten, për të ndihmuar në marrjen e masave për minimizimin e dëmeve të fatkeqësive natyrore.

7. Menaxhimi i investimeve publike duhet të përmirësohet më tej. Përzgjedhja e projekteve duhet të mbështetet në një proces rigoroz vlerësimi dhe përcaktimi të prioritetëve. Ky proces duhet të jetë i unifikuar për të gjitha investimet publike, përfshirë partneritetet publike-private.

8. Mbështetja për shtresat në nevojë dhe bizneset e cenuara duhet të jetë e studiuar, e përligjur, me përfitues të identifikuar, si dhe objekt i transparencës dhe llogaridhënies. Procedurat e menaxhimit të financave publike, të cilat u anashkaluan gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme, duhet të vihen sa më parë brenda rregullave.

9. Menaxhimi me kujdes i risqeve fiskale është një detyrim tjetër i rëndësishëm. Në këtë kuadër, duhet të përmirësohet menaxhimi i risqeve nga PPP-të. Ministria e Financave dhe Ekonomia duhet të rrisë kapacitetet monitoruese dhe të raportojë me transparencë për këtë çështje. Gjithashtu, më shumë përpjekje duhet të bëhen për përmirësimin e ecurisë së ndërmarrjeve shtetërore të sektorit të energjisë elektrike, të cilat mbartin risqe të vazhdueshme fiskale.

* * *

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi edhe raportet në parim të komisioneve të tjera të Kuvendit për projektbuxhetin. Në këto raporte theksohet se të gjitha komisionet e kanë miratuar në parim projektbuxhetin me votat pro të shumicës së deputetëve, duke dhënë edhe argumentet përkatëse. Disa komisione kanë paraqitur kërkesa për shtesë shpenzimesh në disa institucione buxhetore. Të gjitha kërkesat për rishikimin e projektbuxhetit do të shqyrtohen nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat gjatë fazës së shqyrtimit nen për nen të tij, për të bërë të mundur mbështetjen e kërkesave më të domosdoshme e prioritare brenda mundësive që paraqet projektbuxheti.

V. Përfundim.

Mbështetur në vlerësimet dhe argumentet si më lart, Komisioni e miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021” me shumicë votash.

RELATORI

Anastas ANGJELI

Blerina GJYLAMETI

KRYETARJA

Milva EKONOMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 13.11.2020

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”

(shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi)

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 9, 10, 12 dhe 13 dhjetor 2020, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura e shqyrtimit të projektbuxhetit nen për nen u mbështet në nenet 32-39 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Relatorë, për këtë projektligj, janë z. Anastas Angjeli dhe znj. Blerina Gjylameti.

Shqyrtimi nen për nen i projektbuxhetit u zhvillua pas miratimit në parim të tij, në seancën plenare të datës 5 nëntor 2020.

Në mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm Ministrja e Financave dhe drejtues të stafit të kësaj ministrie, të cilët dhanë informacionet përkatëse për pyetjet e deputetëve.

Komisioni zhvilloi seanca dëgjimore të posaçme me Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrin e Shtetit për Rindërtimin, Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, drejtues të pushtetit vendor, si dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve. Këto seanca dëgjimore u zhvilluan për t’u njohur më në detaj dhe për të analizuar më në thellësi projektbuxhetin në sektorët prioritarë të

Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto seanca u kryen në vijim të seancave dëgjimore në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat u zhvilluan gjatë pjesës në parim të shqyrtimit të projektligjit, siç pasqyrohet në raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për vlerësimin në parim të projektbuxhetit.

II. Diskutimi në Komision.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat u njoh me raportet e komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit, si dhe me disa propozime të institucioneve kushtetuese e të pavarura dhe të shoqërisë civile për projektbuxhetin. Në të gjitha raportet e komisioneve të tjera theksohet se projektbuxheti është miratuar, nen për nen dhe në tërësi, me shumicë votash. Disa komisione kanë propozuar ndryshime në shpenzimet e parashikuara për vitin 2021 për ministritë dhe institucionet e fushës që ato mbulojnë, duke dhënë edhe argumentet mbështetëse.

Mbështetur në analizën e shqyrtimit në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”, seancat dëgjimore, raportet e komisioneve të tjera dhe propozimet e shoqërisë civile, Komisioni për Ekonominë dhe Financat përcaktoi sektorët prioritarë, të cilët duhet të mbështeten me një financim më të madh se ai i parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2021. Gjithashtu, Komisioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, analizoi mundësitë që paraqet projektbuxheti i vitit të ardhshëm për të përballuar shtesën e shpenzimeve për sektorët prioritarë. Prioritetet e përcaktuara nga Komisioni janë si më poshtë:

Së pari, mbështetja e sektorit të shëndetësisë.

Komisioni gjykon se sektori më i rëndësishëm, që duhet të ketë një mbështetje më të madhe buxhetore, është sektori i shëndetësisë. Projektbuxheti i vitit 2021, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është rritur me rreth 2.4 miliardë lekë ose 3.6 pikë përqindje në krahasim me vitin 2020, pa përfshirë shtesën për rritjen e pagave në sektorin e shëndetësisë prej 4.5 miliardë lekësh. Ky projektbuxhet parashikon një fond prej rreth 6 miliardë lekësh për përballimin e pandemisë, ku një vend të rëndësishëm zenë shpenzimet për vaksinën anti-COVID prej 1.5 miliardë lekësh. Pagat për mjekët, infermierët dhe laborantët, që prej datës 1 janar 2021, do të rriten me 40 për qind.

Por, duke parë përshpejtimin e përhapjes së pandemisë tek qytetarët dhe riskun e mundshëm të zgjerimit të këtij fenomeni gjatë periudhës së dimrit, Komisioni sugjeron që në projektbuxhetin e vitit 2021, të shtohen shpenzimet me 1.2 miliardë lekë, për të përfshirë paketën e rimbursimit të ilaçeve për kurimin nga pandemia Covid-19, në listën e ilaçeve të rimbursueshme. Rimbursimi i çmimit të ilaçeve nga buxheti i shtetit do të bëhet për të gjithë qytetarët dhe në të gjithë vendin.

Së dyti, mbështetja e shtresave sociale në nevojë.

Komisioni gjykon që shtresat sociale, që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie, duhet të kenë një mbështetje më të madhe buxhetore, për të përballuar jetesën, veçanërisht në situatën aktuale të pandemisë shëndetësore. Për këtë qëllim, Komisioni propozon që në projektbuxhetin e vitit 2021 të shtohen shpenzimet për këtë kategori sociale me 2.5 miliardë lekë.

Së treti, mbështetja e procesit të rindërtimit.

Procesi i rindërtimit të vendit përbën një prioritet tjetër të rëndësishëm, për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019. Ky proces do të ndikojë pozitivisht edhe në rigjallërimin e ekonomisë. Për këtë arsye, Komisioni mbështet parashikimin e projektbuxhetit prej 28 miliardë lekësh në këtë drejtim.

Së katërti, mbështetja për sektorin e turizmit.

Komisioni është i mendimit që edhe sektori i turizmit duhet të ketë një mbështetje më të madhe nga projektbuxheti, pasi është një sektor që jep një kontribut të rëndësishëm në ekonomi dhe punësim. Gjatë vitit 2020 ky sektor pësoi goditjet më të mëdha nga tërmeti dhe pandemia. Për të rigjallëruar këtë sektor, Komisioni propozon dhënien e një mbështetjeje më të madhe ndaj njësive të qeverisjes vendore me potencial më të lartë turistik. Gjithashtu, vijimi i reformave në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, si sektorin e ujit, energjisë, infrastrukturës etj do të japin ndikimin e tyre pozitiv në këtë sektor.

Së pesti, mbështetja për rigjallërimin e ekonomisë.

Komisioni mbështet zhvillimin e disa sektorëve prioritarë në vendin tonë, që kanë potencial për daljen nga recensionin dhe rikthimin drejt rritjes ekonomike. Sektori i bujqësisë dhe kontribut

pozitiv në zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e eksporteve gjatë vitit 2020. Për vitin 2021, Komisioni propozon rritjen e buxhetit për rehabilitimin e skemave ujitëse. Gjithashtu, Komisioni propozon rritjen e mbështetjes buxhetore për Agjencinë e Efiçencës së Energjisë dhe për investimet e huaja, si dhe zgjidhjen e disa problematikave në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhënia e shpërblimit për naftëtarët dhe mbështetja për disa ndërmarrje që janë në konservim, për të mos krijuar problematika në drejtim të pagesës së detyrimeve të tyre.

Së gjashiti, mbështetja për ekonominë e gjelbër, ekonominë dixhitale dhe objektivat e zhvillimit të qendrueshëm.

Komisioni mbështet parashikimet e projektbuxhetit për zgjerimin e ekonomisë së gjelbër. Ai propozon rritjen e mbështetjes në këtë drejtim, përmes dhënies së një fondi shtesë prej 150 milionë lekësh, mbi atë të parashikuar në projektbuxhet, në programin për mbrojtjen e mjedisit.

Gjithashtu, Komisioni mbështet parashikimet e projektbuxhetit në drejtim të dixhitalizimit. Kjo mbështetje do të sigurohet nëpërmjet shtimit të shërbimeve elektronike për qytetarët, administratën dhe biznesin; përdorimit gjerësisht të teknologjisë së informacionit në edukim, shëndetësi etj; si dhe shtrirjes e zgjerimit të infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e vendit.

Mbështetja që i jepet me këtë projektbuxhet shtesave në nevojë, reformat që parashikohen në sektorët prioritarë të ekonomisë, pritshmëritë pozitive në drejtim të rritjes ekonomike dhe punësimit, janë disa nga faktorët kryesorë që pritet të ndikojnë në plotësimin e objektivave afatshkurtra e afatmesme dhe afatgjata, duke ecur në të njejtën linjë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të Axhendës 2030.

Së shtati, mbështetja e reformës në drejtësi dhe reformës institucionale.

Komisioni propozon një mbështetje më të madhe buxhetore për institucionet e reformës në drejtësi, për të siguruar vijimësinë e këtij procesi, të vlerësuar pozitivisht edhe nga BE dhe SHBA. Gjithashtu, mbështetje më e madhe buxhetore propozohet edhe për disa institucione kushtetuese e të pavarura, për të siguruar një funksionim më të mirë të tyre.

Së teti, mbështetja e funksionimit të pushtetit vendor.

Në seancën dëgjimore me përfaqësues të qeverisjes vendore, Komisioni u njoh me disa problematika të buxhetit të tyre. Për këtë arsye, Komisioni propozon rishikimin e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar dhe transfertës specifike dhe rritjen e mbështetjes buxhetore për disa bashki. Kjo mbështetje duhet të jetë më e madhe për bashkitë e goditura nga tërmeti, bashkitë që kanë më shumë veprimtari biznesi në territorin e tyre dhe bashkitë më të goditura nga përkeqësimi i turizmit, për shkak të pandemisë.

III. Ndryshime në projektligj.

Mbështetur në këto prioritete, Komisioni miratoi disa ndryshime në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, si më poshtë:

III.1. Ndryshime në nenet e projektligjit.

Në **nenin 5**, paragrafi i dytë riformulohet si më poshtë:

“Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11700 milionë lekësh, përfshirë detyrimet e prapambetura, nga i cili 1200 milionë lekë përdoret për rimbursimin e medikamenteve për kurimin e Covid 19. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në **nenin 10**, paragrafi i tretë dhe i katërt ndryshohen si më poshtë:

“Vlera indikative e financimit, nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, është rreth 13 052 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative, si më poshtë:

- ✓ Huamarrje afatgjata të destinuara për projekte me vlerë rreth 24 178 milionë lekë;
- ✓ Huamarrje në formën “mbështetjeje buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare, me vlerë rreth 29 764 milionë lekë;
- ✓ Ripagesa të principalit me vlerë rreth - 40 890 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit, nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë, është rreth 39 742 milionë lekë.”.

Në nenin 11, pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit prej 1 miliardë lekësh, të percaktuar në Programin e Zhvillimit Rural për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë, si dhe financimi i ngritjes së sistemit të shpërndarjes dhe monitorimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2021, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 49 452 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 62 952 milionë lekë.
- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në (minus) -13 500 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 331 953 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 225 526 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore 55 628 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 800 milionë lekë.”.

III.2. Ndryshime në tabelat e projektligjit.

1. Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shtohen shpenzimet korrente me 3.7 miliardë lekë, nga të cilat:

- Shtohen 1.2 miliardë lekë për rimbursim medikamentesh, në kuadër të situatës së pandemisë shëndetësore;
- Në Programin “Përkujdesi social” shtohen shpenzimet me 2.5 miliardë lekë, për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

2. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Në programin 04240 “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, shpenzimet kapitale shtohen me 200 milionë lekë, në projektin e rehabilitimit të skemave ujitëse, i cili përfundon në maj 2021.
- Në programin (04250) “Zhvillimi Rural, duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun” shpenzimet kapitale pakësohen me 200 milionë lekë, në projektin që lidhet me skemën e garancisë me Berzh.
- Në programin (04250) “Zhvillimi Rural, duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun” pakësohen shpenzimet korrente me 50 milionë lekë dhe shtohen shpenzimet kapitale me të njëjtën vlerë. Ky ndryshim saktëson skemën për mbështetjen e fermerëve, përmes skemës së re të subvencionimit të naftës.

3. Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë rriten shpenzimet me 54 milionë lekë, nga të cilat:

- Shpenzimet korrente rriten me 14 milionë lekë, për mbështetjen e funksionimit të Agjencisë së Eficencës së Energjisë (financimin e strukturës së re që do të miratohet, mbështetjen e projekteve etj).
- Shpenzimet kapitale në programin “Mbështetje për Burimet Natyrore”, rriten me 20 milionë lekë. Kjo shtesë shpenzimesh nevojitet për mbështetjen e ndërmarrjeve në konservim, si Albminera, Albakër dhe Albkrom, Ndërmarrjes së Ndërtimit të Hidrocentralit Banjës-Elbasan dhe ndërmarrjeve të tjera të së njëjtës natyrë, në të cilat janë krijuar detyrime të mbartura në paga, sigurime shoqërore e tatime, për shkak të mospërballimit të shpenzimeve me buxhetin ekzistues.
- Shpenzimet kapitale me financim të huaj në programin “Mbështetje për rrjetet e komunikacionit” shtohen me 20 milionë lekë dhe do të përdoren për një projekt grant të BE.

4. Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit rriten shpenzimet për ekonominë e gjelbër dhe mbështetjen e sektorit të turizmit. Shpenzimet kapitale ndryshohen si më poshtë:

- Rriten me 150 milionë lekë shpenzimet në Programin “Mbrojtja e Mjedisit”, nga të cilat 50 milionë lekë shpenzime korrente dhe 100 milionë lekë shpenzime kapitale për projektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend depozitimet ekzistuese”.
- Shpenzimet kapitale në programin “Zhvillimi i turizmit” pakësohen me 100 milionë lekë në fondet e programit të skemës së garancisë me Berzh.

5. Në Ministrinë e Drejtësisë bëhet një rialokim midis programeve në shpenzimet korrente, si më poshtë:

- Shtohen shpenzimet në Programin “Sistemi i Burgjeve” me 42 milionë lekë;
- Pakësohen shpenzimet në Programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” me të njejtën vlerë.

Ky ndryshim propozohet për të mbështetur reformën në Sistemin Penitenciar.

6. Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë bëhet një rialokim midis zërave të shpenzimeve në Programin “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”, duke shtuar shpenzimet korrente me 35 milionë lekë dhe pakësuar shpenzimet kapitale me të njejtën vlerë.

7. Në Komisionerin e Pavarur të Kualifikimit shtohen 12 këshilltarë dhe 37 milionë lekë shpenzime personeli, për të mbështetur reformën në drejtësi.

8. Në Kolegjin e Posaçëm të Apelit shtohen 6 këshilltarë dhe 20 milionë lekë shpenzime personeli, për të mbështetur reformën në drejtësi.

9. Në Këshillin e Lartë të Prokurorisë bëhen rialokime të brendshme, duke shtuar shpenzimet korrente me 3 milionë lekë dhe duke pakësuar shpenzimet kapitale me të njejtën vlerë.

10. Në Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi shtohen shpenzimet kapitale me 3 milionë lekë, të nevojshme për rikonstruksionin e godinës së institucionit.

11. Në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit shtohen 10 punonjës në organikë, në përputhje me strukturën e miratuar nga Kuvendi dhe 10 milionë lekë shpenzime kapitale (pagesë TVSH dhe pajisje).

12. Në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë shtohen shpenzimet korrente me 15 milionë lekë, të nevojshme për aktivitetin e plotë të këtij institucioni.

13. Në Shkollën e Magjistraturës bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Shtohen 3 punonjës në organikë;
- Shtohen shpenzimet e personelit me 2 milionë lekë, për të përballuar shtesën e numrit të punonjësve;
- Shtohen shpenzimet korrente me 60 milionë lekë, në zërin transferata për individët dhe bursat, për përballimin e bursave të kandidatëve për magjistratë të vitit të parë dhe të dytë, si dhe për kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë;

14. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve bëhen këto ndryshime, pas miratimit të strukturës së re nga Kuvendi;

- Shtohen 14 punonjës në organikë;
- Shtohen shpenzimet me 44 milionë lekë, nga të cilat:
 - ✓ Shpenzime personeli 29 milionë lekë;
 - ✓ Shpenzime kapitale 15 milionë lekë për pajisje dhe rikonstruksione.

15. Në projektbuxhetin e Kuvendit bëhen këto ndryshime e shtesa:

- Shtohen 2 punonjës në organikë (pa shtesë për shpenzime personeli);
- Shtohen shpenzimet në programin “Shërbimi administrativ” me 100 milionë lekë, nga të cilat:
 - ✓ *Shpenzime korrente* 30 milionë lekë, të cilat janë të nevojshme për mirëmbajtjen e sistemeve IT elektronike, si: të votimit në sallën e seancave plenare, audio-vidio në sallat e komisioneve, e-parlament, wireless, platformës ndëristitucionale dhe ndërtimit të infrastrukturës virtuale, bazuar në kontratat e angazhuara.
 - ✓ *Shpenzime kapitale* 70 milionë lekë, të cilat janë të nevojshme për përmirësimin e sistemit digital IT, bashkëfinancimin e projektit me qeverinë Sviceriane, sistemit backup dhe sistemit të energjisë elektrike, për të mbështetur veprimtarinë e institucionit, veçanërisht në kushtet e pandemisë shëndetësore.

16. Në Kontrollin e Lartë të Shtetit shtohen shpenzimet me 14 milionë lekë, nga të cilat:

- Shpenzime personeli 3 milionë lekë;
- Shpenzime kapitale me financim të huaj 11 milionë lekë.

17. Në Komisionerin e Prokurimit Publik shtohen shpenzimet korrente me 2 milionë lekë.

18. Në Avokatin e Popullit shtohen shpenzimet kapitale me 1 milionë lekë.

19. Në Akademinë e Shkencave shtohen shpenzimet korrente me 10 milionë lekë, për funksionimin e institucionit.

20. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Radiotelevizionit Shqiptar shtohen shpenzimet korrente me 36 milionë lekë, për të financuar programe të ndryshme, si dhe projekte teknike e teknologjike.

21. Në Agjencinë Telegrafike Shqiptare shtohen shpenzimet kapitale me 5 milionë lekë, të nevojshme për zëvendësimin e pajisjeve teknologjike të amortizuara, dixhitalizimin e arkivës së fotografisë dhe buletinëve të shkruar.

22. Në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë shtohen shpenzimet korrente me 10 milionë lekë, për financimin e projekteve kinematografike me mbështetje të huaj.

23. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave shtohen shpenzimet korrente me 9 milionë lekë për funksionimin e institucionit.

24. Në Ministrinë e Kulturës shtohen shpenzimet kapitale për ndërtimin e Teatrit Kombëtar, nga Bashkia e Tiranës, me 600 milionë lekë.

25. Në buxhetin vendor bëhen këto ndryshime:

- Në tabelën 3, në kolonën “Shtesë nga Kuvendi”:
 - shtohet transferta e pakushtëzuar në disa bashki me 250 milionë lekë sipas tabelës bashkëlidhur.
 - shtohet transferta e pakushtëzuar sektoriale për shpenzimet kapitale për rrugët me 250 milionë lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

26. Në nenin 14, paragrafi i parë, nënpika e parë, pas fjalëve “raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme në masën 2 000 milionë lekë”, shtohen fjalët “nga i cili 560 milionë lekë për pagesën e naftëtarëve”.

Në tabelën 4 “Treguesit fiskalë të buxhetit”, në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave, prej 2000 milionë lekësh, shtohet një specifikim me këtë përmbajtje: “Nga i cili 560 milionë lekë për pagesën e naftëtarëve”.

27. Burimet:

Rritja e totalit të shpenzimeve të buxhetit me 5 282 milionë lekë do të mbulohet nga:

- Shkurtimi i granteve në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të kompensuar rritjen prej 31 milionë lekësh në fondet e granteve si më sipër.
- Reduktimi me 310 milionë lekë i shpenzimeve të parashikuara për censusin e popullsisë dhe banesave, i cili do të zbatohet në vitin 2022;
- Reduktimi i shpenzimeve për investime në Ministrinë e Mbrojtjes me 300 milionë lekë.
- Rritja e të ardhurave tatimore nga TVSH me 4 641 milionë lekë.

III.3. Të gjitha ndryshimet e mësipërme të pasqyrohen në tabelat dhe nenet e projektligjit.

IV. Rekomandim.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat i rekomandon Këshillit të Ministrave që, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të ndjekin me vëmendje risqet e mundshme, për shkak të situatës së pandemisë shëndetësore Covid-19 dhe të ndikimit të saj në situatën ekonomike, me qëllim që në çdo kohë, të marrin masat e nevojshme për garantimin e likuiditetit për financimin e ekonomisë.

V. Përfundim.

Komisioni e miratoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, nen për nen dhe në tërësi, me shumicë votash, me ndryshimet si më lart.

RELATORET

Anastas ANGJELI

Blerina GJYLAMETI

KRYETARJA

Milva EKONOMI